



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt.31.05.2012, nenit 21, 22 dhe 44, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05nr.350/02 –121089/21 dt.25.06.2021 të kërkuesve: pronarit Burim Mehmeti nga Prishtina dhe Investitorit, “Pozhegu Brothers” Sh.P.K. nga Prishtina, me adresë në Rr.Muharrem Fejza, Mat 1, Bll/C11/A1, Lok4, në Prishtinë, e përfaqësuar nga z. Qemajl Pozhegu nga Gjakova, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa individuale banimore/ 9 shtëpi familjare, prej të cilave 8 shtëpi familjare janë në varg: Tipi: “1N”, “2N”, “3N”, “4N”, “5N”, “6N”, “7N”, “8N”, dhe 1 shtëpi familjare e veçantë: Tipi “1T”, në kuadër të Bllokut urban “D-01”, të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia 2016-2024” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt për vendosjen e çështjes administrative me datë 22.06.2023 merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore, pronarit Burim Mehmeti nga Prishtina dhe Investitorit, “Pozhegu Brothers” Sh.P.K. nga Prishtina, me adresë në Rr.Muharrem Fejza, Mat 1, Bll/C11/A1, Lok4, në Prishtinë me certifikatë të regjistrimit të biznesit me numër unik nga ARBK-së 811251032,e përfaqësuar nga z/ Qemajl Pozhegu nga Gjakova, sipas kërkesës 05nr.350/02 –121089/21 dt.25.06.2021, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, dhe lejimin e ndërtimit të Kompleksit të ndërtesave individuale banimore/ 9 (nëntë) shtëpive familjare, prej të cilave 8 (tetë) janë shtëpi në varg të tipit “N”, “1N-8N” me etazhitet S+P+1, dhe 1 (një) shtëpi individuale e tipit “T” – “1T” me etazhitet B+S+P+1, në kuadër të Bllokut urban “D-01”, të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia 2016-2024” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.01244-0 ZK. Prishtinë, sipas projekt propozimit/Plani i situacionit-“zgjdhja urbane”, të prezantuar në këtë drejtori.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilën caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Tërësia “D”, Blloku urban “D-01”, të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia 2016-2024”, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 031-247790 dt. 04.10.2016, ku sipas këtij plani, destinimi është “banim individual i ulët”.

Për kriteret urbane, parametrat dhe kushtet e ndërtimit sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, pronari është informuar me “Informim nga Plani Rregullues të Hollësishëm “Sofalia 2016-2024”, me nr.04-350/01-77108/21 të datës 05.05.2021, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:

- Nr. 01244-0; ZK. Prishtinë, .. S=2588m²;... Burim Mehmeti;... “Arë e klasës 6”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Bazuar në gjendjen faktike dhe incizimin gjeodezik të lokacionit, në kuadër të parcelë kadastrale të trajtuar, nuk ka ndërtim;
- Është tokë urbane, me mundësi të kyçjes në infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj;
- Terreni është i pjerrët, me rënie kah ana verilindore;
- Në diametër prej 50m’ ka shtëpi të ndërtuara, kryesisht me destinim “banim individual”;

- Parcela ka qasje direkte në rrugën ekzistuese publike "Llazar Siliqi", dhe e njëjta është planifikuar të zgjerohet sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia 2016-2024";

IV. Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" e Kompleksit të ndërtesave individuale banimore/ 9 (nëntë) shtëpive familjare, prej të cilave 8 (tetë) janë shtëpi në varg të tipit "N", "1N-8N" me etazhitet S+P+1, dhe 1 (një) shtëpi individuale e tipit "T" – "1T" me etazhitet B+S+P+1, në kuadër të Bllokut urban "D-01", të Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia 2016-2024" në Prishtinë, është konceptuar të zhvillohet dhe realizohet me trajtim të sipërfaqes së parcelës kadastrale, nr. 1244-0 ZK. Prishtinë, që përfshihet në ndërtim dhe pjesë të kësaj parcele në funksion të zgjerimit dhe funksionimit normativ të rrugës dhe e ndarë në 9 (nëntë) parcela ndërtimore si:

1) Rruga e planifikuar për shërbim dhe furnizim në kuadër të Kompleksit të ndërtesave me sipërfaqe prej $S=497m^2$;

2) Tipi: "1N-2N", - Shtëpitë në varg, me sipërfaqe totale ndërtimore $S=380m^2$, të shpërndara nëpër etazhe: Suterren me $S=60m^2$, Përdhesë me $S=65m^2$, Kati I me $S=65m^2$;

3) Tipi: "3N, 4N, 5N, 7N", - Shtëpitë në varg, me sipërfaqe totale ndërtimore $S=760m^2$, të shpërndara nëpër etazhe: Suterren me $S=60m^2$, Përdhesë me $S=70m^2$, Kati I me $S=60m^2$;

4) Tipi: "6N", - Shtëpi në varg, me sipërfaqe totale ndërtimore $S=190m^2$, e shpërndarë nëpër etazhe: Suterren me $S=60m^2$, Përdhesë me $S=66m^2$, Kati I me $S=60m^2$;

5) Tipi: "8N", - Shtëpi në varg, me sipërfaqe totale ndërtimore $S=190m^2$, e shpërndarë nëpër etazhe: Suterren me $S=60m^2$, Përdhesë me $S=70m^2$, Kati I me $S=60m^2$;

6) Tipi: "1T", - Shtëpi e veçantë, me sipërfaqe totale ndërtimore $S=636.77m^2$, e shpërndarë nëpër etazhe: Bodrumi me $S=147.37m^2$, Suterren me $S=196.4m^2$, Përdhesë me $S=163m^2$, Kati I me $S=130m^2$.

V. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin Kompleksit të ndërtesave individuale banimore/ 9 (nëntë) shtëpive familjare, të tipit "N", "1N-8N" e tipit "T" – "1T", në kuadër të Bllokut urban "D-01", të Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia 2016-2024" në Prishtinë, përcaktohen duke u bazuar në parametrat urban të planit dhe projekt-propozimit, dhe ato do të jenë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale/ndërtimore, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesave, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesave nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik Plani i situacionit- "zgjidhja urbane", si dhe në bazë të 'Situacionit' të parcelës me vijën ndërtimore dhe rregulluese në sistemin koordinativ KOSOVAREF01", bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia 2016-2024", është e planifikuar me destinim "Banim individual i ulët", me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, hapësira për parking, etj. (sipas projektit konceptual të prezantuar);
- Parcelat ndërtimore, sipas riparcelimit nuk mund të planifikohen më të vogla se $400m^2$, për shtëpi të veçanta;
- Për shtëpitë dyshe (e ngjitur në njëren anë) minimumi i parcelës është 3 ari ($300m^2$);
- Për shtëpitë në rend (e ngjitur në të dy anët) minimumi i parcelës për ndërtim është 2 ari ($200m^2$);
- Etazhiteti i shtëpive, sipas planit rregullues është max P+2 etazhe, ku sipas projekt propozimit të zgjidhjes urbane, tipi "N" (1N-8N) ka etazhitet S+P+1, ndërsa tipi "T" (1T) ka etazhitet B+S+P+1;
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës kadastrale nr.01244-0 ZK. Prishtinë, planifikohet ndërtimi i Kompleksit të shtëpive individuale banimore-shtëpive familjare, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas llogarive dhe projektit konceptual, si në vijim:

Kompleksit të ndërtesave individuale banimore/ 9 (nëntë) shtëpive familjare, të tipit "N", prej "1N-8N" dhe e tipit "T" – "1T"

- $S = 485.57 m^2$ / sipërfaqe nëntokësore ndërtimore
- $S = 1671.2 m^2$ / sipërfaqe mbitokësore ndërtimore
- $S = 2156.77 m^2$ / sipërfaqe totale ndërtimore
- Etazhitet; N/S+P+1 dhe T/B+S+P+1;

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore - brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhesës ose suterren, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, është max.30%;

Kompleksi i ndërtesave individuale-shtëpive familjare të Tipit: "N" dhe "T"

-Tipi "N"/ $S = 200 m^2 \times 0.3 (30\%) = 60 m^2$ / sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia",

$S = 200 m^2 \times 0.4 (40\%) = 80 m^2$ / sipas Vendimit 01nr.031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit,

S = max. 35 %, sipas projekt propozimit;

-Tipi "T"/ S = $497 \text{ m}^2 \times 0.3$ (30%)=149.1 m^2 / sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia",
S= $497 \text{ m}^2 \times 0.4$ (40%)=198.8 m^2 / sipas Vendimit 01nr.031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit,
S = max. 39 %, sipas projekt propozimit;

- Bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës me Nr.01-031-185481 dt.14.08.2015, shfrytëzimi i parcelës (ISHP) mund të rritet 10% më shumë se maksimumi i lejuar me planin në fuqi, dhe është miratuar në këtë rast, me kusht të zhvillimit të arkitekturës së qëndrueshme (*duhet hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës*), duke marrë parasysh indikatorë/faktorë të arkitekturës së qëndrueshme si citojmë: " Shfrytëzimi i mirë i parcelës, orientimi ideal i objektit (varësisht nga lloji i objektit); Planifikimi dhe shfrytëzimi i gjelbërimit (të lartë, të ulët etj) në favor të qëndrueshmërisë së mjedisit; Planifikimi dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtrishme të përfitimit të energjisë elektrike dhe të ngrohjes (era, dielli, uji, etj.); Planifikimi dhe shfrytëzimi i sistemeve të ventilimit dhe ftohjes; Planifikimi dhe shfrytëzimi i sistemeve të riciklimit të ujërave (atmosferike, ujërave gri etj.); Planifikimi dhe trajtimi i ujërave të zeza para shkarkimit të tyre në rrjetin e kanalizimit; Planifikimi dhe përdorimi i materialeve të qëndrueshme, përfutuar kryesisht nga burimet e ripërtrishme, nga materialet e ricikluara etj.;Planifikimi me menaxhimin e mbeturinave të ndërtimit në vend ndërtim para, gjatë dhe pas fazës së ndërtimit."
- Koeficienti ndërtimor i parcelës kadastrale brenda vijës rregulluese- parcelës ndërtimore është 0.8, do të llogaritet si në vijim: 100% për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , 50% për etazhet me vëllim mbi 51% mbi tokësuteren, dhe 0% për etazhet e nëntokës- bodrume;

Kompleksi i ndërtesave individuale-shtëpive familjare të Tipit: "N" dhe "T",

Tipi: "N",

S= $200 \times 0.8=160 \text{ m}^2$,/i lejuar sipas planit/,

S= 160 m^2 - sipas projekt propozimit,

Tipi: "T",

S= $497 \times 0.8=397.6 \text{ m}^2$, /i lejuar sipas planit/,

S= 391.2 m^2 - sipas projekt propozimit,

- Indeksi i shfrytëzimit të nëntokës (ISN), sipas planit është 0.5,

Kompleksi i ndërtesave individuale-shtëpive familjare të Tipit: "N" dhe "T",

Tipi: "N",

S= $200 \times 0.5=100 \text{ m}^2$,/i lejuar sipas planit/,

S= 60 m^2 - sipas projekt propozimit,

Tipi: "T",

S= $497 \times 0.5=248.5 \text{ m}^2$, /i lejuar sipas planit/,

S= 147.37 m^2 - sipas projekt propozimit;

- Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit (ISGJ), sipas planit rregullues është max.0.5., bazuar në paragrafin II. pika 2 të Vendimit 01 nr.031-185481 dt.14.08.2015 , të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është min.40%, dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim të ulët dhe të lartë është 30%, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion dhe sipas kalkulimeve kjo sipërfaqe duhet të jetë:

Kompleksi i ndërtesave individuale-shtëpive familjare të Tipit: "N" dhe "T",

Tipi: "N",

S= $200 \times 0.5=100 \text{ m}^2$,/i lejuar sipas planit/,

S= $200 \text{ m}^2 \times 0.4=80 \text{ m}^2$ - sipas Vendimit të Kryetarit,

,S= $200 \text{ m}^2 \times 0.3=60 \text{ m}^2$ - sipas Vendimit të Kryetarit, /

Tipi: "T",

S= $497 \times 0.5=248.5 \text{ m}^2$, /i lejuar sipas planit/,

S= $497 \times 0.4=198.8 \text{ m}^2$, sipas Vendimit të Kryetarit,

S= $497 \times 0.3=149.1 \text{ m}^2$, sipas Vendimit të Kryetarit, /

- Me këto kushte ndërtimore miratohet shfrytëzimi i parcelës 30% +10 % gjelbërim, ku pala obligohet që me projekt kryesor të planifikoj arkitekturën e qëndrueshme/kulmet e gjelbërta. Elaborati për kulmet e gjelbërta, bazuar në Vendimin 01 nr.031-185481 dt.14.08.2015 , të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, duhet hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë për sigurimin e pëlqimit për masat e ndërmarra në realizimin e kulmeve të gjelbërta, për ndërtesat /shtëpitë individuale;

- Qasja në parcela duhet të realizohet nga rrugët ekzistuese dhe të planifikuara sipas Planit Rregullues të Hollësishtëm "Sofalia" dhe nga rruga e propozuar sipas propozimit të pronarit/investitorit;
- Distanca e vendosjes së ndërtesave ndaj kufirit të parcelës fqinje, për kthina primare është min 0.5H;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Nëse në fasadat e shtëpive me orientim nga fqinjët kanë hapje sekondare si shkallë, depo, banjo e të tilla kthina të ngjashme, të cilat nuk kanë nevojë për diellzim, por vetëm për ndriçim dhe ajrosje, distanca minimale është 0.2h nga kufiri i parcelës (në marrëveshje me fqinun deri në bashkim të plotë);
- Kuota e përdhësës së ndërtesës përcaktohet në raport me kuotën e nivelit të rrugës publike nga e cila ka qasje parcela, gjegjësisht me kuotën zero;
- Kuota e përdhësës së ndërtesave të reja nuk mund të jetë më e ulët se kuota e niveletës së rrugës publike;
- Distanca në mes vijës ndërtimore dhe asaj rregulluese është 5.0m;
- Në rastet kur parcela ka pjerrtësi, terreni i tillë që mbulon më shumë se sa një kat në njërin drejtim, atëherë sipërfaqe ndërtimore llogaritet 50%;
- Me kërkesë të posaçme dhe duke marrë pëlqimin e qytetarëve në rreze prej 50m, mund të lejohet edhe ndërtimi i shërbimeve të tjera jo shqetësuese, me qëllime afariste, ndërmarrje tregtare, zeytare, fetare, kulturore, sportive etj., duke përfshirë edhe hapësirat shërbyese;
- Kati përdhësë i ndërtesës, për t'u konsideruar kat i plotë, duhet të jetë së paku 1.4m mbi sipërfaqen tokësore, duhet të ketë së paku 2/3 të sipërfaqes së vet në lartësi minimale prej 2.3m;
- Për të siguruar pamje të përshtatshme dhe të organizuar të kulmeve në zonë, këndi i kulmeve të pjerrëta është kufizuar në maksimum 45°;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që uji i strehëve duhet të pikojë brenda parcelës kadastrale;
- Lejohet rrethim me gardh të shtëpitë individuale deri në lartësi 1.4m (nga kuota e trotuarit), nga ku 50% duhet të jetë transparente;
- Gardhi duhet të vendoset në vijën rregulluese, në formë që shtyllat e gardhit të gjenden brenda parcelës ndërtimore që rrethohet dhe dyert duhet të hapen brenda parcelës;
- Përmbajtjet e banimit duhet të kenë 1 vendparkim për njësi banimi;
- Gjatë ndërtimit të ndërtesave, ndërtesat fqinje të sigurohen me masat mbrojtëse adekuate;
- Arkitektura e ndërtesës së re t'i përshtatet ambientit që e rrethon dhe vlerave ambientale.

VI. Ndarja/parcelimi i parcelës kadastrale nr.01244-0 ZK. Prishtinë do të realizohet sipas Situacionit të parcelave ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore, Planit të situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar.

Para aplikimit për leje ndërtimore, duhet të bëhet ndarja e parcelës kadastrale, të përfshira në këtë zgjidhje urbane, në tërësi sipas propozimit të miratuar me vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore.

Bazuar në pikën 6 të nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, pas përfundimit të procedurës së bashkimit dhe ndarjes së parcelave kadastrale, parcela e përfshirë në rrugën e propozuar brenda kompleksit të shtëpive të banimit, të regjistrohesh sipas Ligjit Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të drejtave të Pronës së paluajtshme me destinim rrugë.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekur, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manuali i ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VII. Kyçja në Infrastrukturë -Meqë për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo Drejtori, nevojitet prezantimi i dokumentacionit me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Informatën mbi lokacionin – adresën e saktë të hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të ndërtesës (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujë);
- Kurse, kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimin për kyçje, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos", "Ngrohtorja e Qytetit, PTK;

VIII. Hartimi i dokumentacionit ndërtimor/ projektit kryesor të bëhet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV. Dhe V. Dokumentacioni ndërtimor duhet të dorëzohet në 3 (tri) kopje fizike dhe 1 (një) digjitale, dhe duhet të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionin e ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale – kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dymve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me sinjalizime përkatëse të komunikacionit dhe lidhja-qasja e saj me rrugët dhe komplekset në rrethinë etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detajet e nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektrike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit dhe trafostacionit;
- Projektin e instalimeve hidroteknike me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizimi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore (akustika, termika, masat për efikasitet të energjisë);
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave të terrenit;
- Projekti i Infrastrukturës së lagjes (ujë & kanalizim, makinerisë, elektrike dhe llogaritë statike të mureve mbrojtëse);

IX. Dokumentacioni ndërtimor për Masat mbrojtëse nga zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
 - Situacionin – "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë, me kuota relative dhe absolute;

- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Çertifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

X. Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Çertifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Çertifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;
- Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

XI. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuësit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

XII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore – të parcelës kadastrale 01244-0 ZK. Prishtinë, bazuar në certifikatën e njësisë kadastrale, ku është evidentuar lloji i shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit: Bujqësore, andaj kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr.41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet-parcelat ndërtimore, sipas Plani i situacionit – “zgjdhja urbane”, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e secilës parcelë ndërtimore $S=200+200+200+200+200+200+200+200+497=2097m^2$, bazuar në manualin e ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar si dhe bazuar në kualitetin e tokës së përshkruar në paragrafin III. të këtij vendimi. Këto sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Kompensim - pagesa do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XIII. Pagesa e taksës administrative për leje ndërtimi dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të kalkulohet/realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XIV. Ky Vendim i kushteve ndërtimore është i vlefshëm një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

Ar sy e t i m

Aplikuesit Burim Mehmeti nga Prishtina dhe Investitori "Pozhegu Brothers" Sh.P.K. nga Prishtina, me certifikatë të ARBK-së 811251032 dhe përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Gjakova, sipas kërkesës 05nr.350/02 – 121089/21 dt.25.06.2021, kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e 9 (nëntë) shtëpive në total, prej të cilave 8 (tetë) janë shtëpi në varg të tipit "N", "IN-8N" me etazhitet S+P+1, dhe 1 (një) shtëpi individuale e tipit "T" – "IT" me etazhitet B+S+P+1, në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1244-0 ZK. Prishtinë, e evidentuar në çertifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-01244-0 ZK. Prishtinë, në lokacionin e përshkruar në pikën II. të dispozitivit të këtij Vendimi.

Me kërkesën për kushte ndërtimore, gjatë fazës së trajtimit të kërkesës, është prezantuar dhe trajtuar ky dokumentacion:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale: kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale për parcelën kadastrale nr. 1244-0 ZK Prishtinë, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës;
- "Informata nga Plani Rregullues të Hollësisë "Sofalia" me referencë 05nr.350/01– 77108/21, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dt.05.05.2021;
- Fotokopjet e letërnjoftimeve të pronarit dhe investitorit;
- Rilevimi gjeodezik i terrenit dhe infrastrukturës përcjellëse, punuar nga gjeodeti i Liçencuar Burim Halilaj nga Drenasi me licencë nr.195;
- Certifikatë e regjistrimit të biznesit Pozhegu Brothers SH.P.K., e regjistruar pran ARBK-së 7 me datë 04.08.2008, me numër unik identifikues 811251032;
- Manuali i ndarjes, punuar nga gjeodeti i Liçencuar Burim Halilaj nga Drenasi me licencë nr.195;
- Fotot e lokacionit dhe ndërtesave ekzistuese;
- Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët, rregullimin e raporteve pronësore dhe kalimin e kushtëzuar të pronësisë së paluejtshmërisë në investitorin ", përpiluar te Noter Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.nr.6157/2021 dhe Ref.nr.1635/2021 dt.07.04.2021, e lidhur në mes të, Burim Mehmeti dhe Kompania "Pozhegu Brothers" SH.P.K. nga Prishtina;
- Projekt propozimin – Projektin konceptual/ideor me Situacioni - "zgjidha urbane" të Kompleksit të ndërtesave individuale banimore/ 9 (nëntë) shtëpive familjare, të tipit "N", "IN-8N" me etazhitet S+P+1, dhe 1 (një) shtëpi individuale e tipit "T" – "IT" me etazhitet B+S+P+1, në kuadër të Bllokut urban "D-01", të Planit Rregullues të Hollësisë "Sofalia 2016-2024" në Prishtinë dhe hapësira të planifikuara, hartuar nga Zyrja projektuese Pozhegu Brothers nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK nr. 811251032;
- Vërtetimi i tatimpaguesit Pozhegu Brothers nr.113787/21/93332237135 të datës 22.06.2021;
- Vërtetimi i tatimpaguesit Burim Mehmeti nr.116787/21/21946300 të datës 22.06.2021;

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/02–121089/21 dt.25.06.2021, dhe kërkesës 05-035/01-270649/22 dt.16.12.2022 për miratimin e kushteve ndërtimore sipas kërkesës së aplikuesit, dhe dokumentacionin e prezantuar dhe provave tjera, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për hapësirën - lokacionin, rregullativës ligjore nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, konsultimit të arkivit të drejtorisë për trajtimin e kërkesave për hapësirën - parcelat dhe komplekset ndërtimore në fqinjësi, si dhe projekt propozimit – projektit konceptual me "zgjidhja urbane" të prezantuar, në mënyrë kronologjike konstatoi se: Kërkuesi, pronari Burim Mehmeti dhe investitori "Pozhegu Brothers" SH.P.K. nga Prishtina me kërkesën 05nr.350/02–121089/21 dt.25.06.2021, i janë drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës për caktimin e kushteve ndërtimore në kuadër parcelës kadastrale me nr. 1244-0 ZK Prishtinë, duke prezantuar dokumentacionin përcjellës, dëshmitë e pronësisë së parcelës, projektin konceptual dhe propozimin e situacionit të zgjidhjes urbane për këtë parcelë kadastrale.

Në procedurë të shqyrtimit kjo drejtori konstatoj se parcela kadastrale nr. 1244-0 ZK Prishtinë, përfshihet në kuadër të Tërësia "D", Blloku urban "D-01", të Planit Rregullues të Hollësisë "Sofalia 2016-2024", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 031-247790 dt. 04.10.2016, ku sipas këtij plani, destinimi është "banim individual i ulët".

Hartimi i projekt propozimit të prezantuar me rastin e aplikimit për kushte ndërtimore, u konstatua se nuk është bërë në harmoni me parametrat dhe kriteret e përcaktuara të planit për ndërtesat e banim individual i ulët ,dhe hapësirat në funksion të tyre, (janë prezantuar ndërtesa të banimit të mesëm),andaj është kërkuar përmirësimi

i projektit propozimit sipas vërejtjeve të diskutuara me hartuesin e projektit, dhe plotësimi i lëndës me dokumentacion tjetër teknik. Pala me kërkesën 05-035/01-270649/22 dt.16.12.2022, kërkon që të vazhdohet me caktimin e kushteve ndërtimore sipas këtij projekt propozimi, duke u thirrur në Ligjin për Ndërtim Nr.04/L-110, nenin 18, paragrafi 3. Me procesverbalin e datës 19.01.2023, pas shpjegimeve nga zyrtari përgjegjës se duhen respektuar destinimi i këtij lokacioni, sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 031-247790 dt. 04.10.2016, ku sipas këtij plani, destinimi është “banim individual i ulët”, atëherë pala/përfaqësuesja sipas LRP. nr.6089/2019 REF.Nr.1209/2019, me proces verbal deklaroi se tërhiqet nga kërkesa për miratimin e kushteve sipas projekt propozimit të palëve dhe pajtohet që lënda të vazhdojë me procedurat e rregullta administrative.

Në dokumentacionin e përmirësuar dhe të prezantuar, projekt propozimi/zgjidhja urbane dhe të dokumentacionit tjetër të bashkëngjitur, të bazuar në planifikimet urbane brenda parcelës kadastrale me nr. 1244-0 ZK Prishtinë, pas shqyrtimit të kërkesës dhe duke u bazuar në rregullativën ligjore, konkretisht nenin 18 të Ligjit për ndërtim Nr.04/L -110 dhe UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, me datë 07.03.2023, kjo drejtori vendosi “Njoftim publik”, për njoftimin dhe mundësinë e dhënies së komenteve të pronarëve dhe poseduesve të rrethinës në diametrimin e dritës prej 50m’, i cili njoftim ka qëndruar deri me datë 21.03.2023. Gjatë kësaj periudhe nuk kanë arritur komente/ ankesa në email adresat e vendosura në njoftimin publik, për caktimin të kushteve ndërtimore.

Pasi parcela e lartë cekur është e lidhur direkt me rrugën publike ekzistuese dhe e njëjta është planifikuar me zgjerime sipas Planit Rregullues “Sofalia”, e trajtuar me këtë Vendim, kjo drejtori miraton zgjidhjen urbane të prezantuar nga kompania hartuese e projektit. Me zgjidhjen e propozuar dhe miratuar nga kjo drejtori, janë përcaktuar edhe vijat rregulluese dhe ato ndërtimore, duke respektuar edhe kriteret dhe parametrat urban të planit dhe distanca e tyre në mes ndërtesave dhe nga kufiri i parcelës ndërtimore, poashtu është miratuar në këtë rast zgjidhja urbane, me kusht të zhvillimit të arkitekturës së qëndrueshme, duke marrë parasysh indikatorë/faktorë të arkitekturës së qëndrueshme si dhe me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë për sigurimin e pëlqimit për masat e ndërmarra në realizimin e kulmeve të gjelbërta, për ndërtesat /shtëpitë individuale.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit për komunikacion, konstatohet: *“Pas shqyrtimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të “Pozhegu Brothers” shpk., dhe Burim Mehmeti, ne lagjen “Sofalia” në Prishtinë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-121089/21 dt.25.06.2021, kyçja për automjete në rrugën e ekzistuese “Llazar Siliqi” e cila rrugë është e paraparë edhe me Planin Rregullues “Sofalia”, përmes rrugës së propozuar sipas zgjidhjes urbane për nëntë ndërtesa banimore - shtëpi individuale me etazhitet deri në S+P+1, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e tillë. Kyçjet për automjete për shtëpitë individuale duhet ti përshatet teknikisht rrugës sipas zgjidhjes urbane, dhe të zbatohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjeve. Gjithashtu kyçja e rrugës së propozuar duhet ti përshatet teknikisht rrugës së planifikuar dhe në kohën kur realizohet ajo.”*

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkëngjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, Plani Rregullues “Sofalia”, rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 12 dhe 13 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, si dhe pas përfundimit të procedurës së vendosjes së njoftimit publik, i cili ka qëndruar në lokacion për 5- pesë ditë , meqenëse gjatë kësaj kohe nuk është pranuar ndonjë koment apo sugjerim, ka konstatuar se, kërkuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual/ideor i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të dokumentit të planifikimit hapësinor për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacioni - "zgjidhja urbane" e kompleksit me shtëpi individuale dhe në varg, si dhe hapësirat përcjellëse; Situacioni i parcelës kadastrale me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues i Hollwshwim "Sofalia" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01; Manuali i ndarjes dhe bashkimit të parcelave kadastrale, punuar nga gjeodeti i licencuar Burim Halilaj nga Drenasi me licencë nr.195.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI.

Ky Akt përcjellës u përpilua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj Drejtorie dhe në dosje të Lëndës .


Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05NR.350/02 – 121089/21 DT.22.06.2023**

Zyrtari,
Bahtie Uka,



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



Drejtori,
Arber Sadiki.






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:
Kushtrim Domaneku.

Nënshkrimi: _____

Prishtinë: 12.06.2023

Legjenda:

- Vija Rregulluese sipas PRRU
- Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcelat Kadastrale



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtine


Zona kadastrale / Katastarska zona: Prishtine

Lloji i njësishë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcelle

Nr. i njësishë kadastrale / Br. katastarske jedinice: 1244-0

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 500



Lista e koordinatave			Lista e koordinatave		
Nr	Y	X	Nr	Y	X
1	7515526.952	4724698.912	39	7515460.338	4724688.549
2	7515508.542	4724693.662	40	7515460.499	4724689.013
3	7515495.522	4724688.343	41	7515461.781	4724692.740
4	7515490.201	4724678.133	42	7515462.087	4724693.340
5	7515482.211	4724671.193	43	7515462.673	4724694.171
6	7515477.531	4724666.524	44	7515463.391	4724694.892
7	7515458.340	4724656.724	45	7515464.499	4724695.636
8	7515445.180	4724652.335	46	7515465.745	4724696.117
9	7515432.321	4724656.585	47	7515466.729	4724696.305
10	7515437.741	4724665.964	48	7515468.214	4724696.223
11	7515442.021	4724672.934	49	7515469.617	4724696.728
12	7515453.712	4724689.583	50	7515470.605	4724697.379
13	7515456.822	4724698.693	51	7515471.435	4724698.222
14	7515457.762	4724702.313	52	7515475.433	4724702.759
15	7515466.703	4724712.712	53	7515474.524	4724703.542
16	7515488.733	4724710.362	54	7515470.037	4724707.745
17	7515503.722	4724710.182	55	7515468.961	4724708.753
18	7515511.352	4724708.352	56	7515465.825	4724711.691
19	7515523.482	4724701.202	57	7515477.792	4724707.000
20	7515440.075	4724654.022	58	7515488.133	4724703.958
21	7515440.027	4724654.173	59	7515490.931	4724703.134
22	7515439.873	4724654.922	60	7515490.931	4724702.373
23	7515439.866	4724656.039	61	7515509.216	4724693.854
24	7515440.117	4724657.126	62	7515499.703	4724690.051
25	7515440.386	4724657.741	63	7515483.123	4724699.722
26	7515440.548	4724658.025	64	7515484.116	4724701.360
27	7515447.033	4724668.736	65	7515477.513	4724703.412
28	7515448.036	4724670.423	66	7515476.401	4724703.315
29	7515448.266	4724670.799	67	7515493.596	4724684.647
30	7515448.508	4724671.143	68	7515490.346	4724678.412
31	7515449.735	4724672.891	69	7515485.279	4724673.858
32	7515452.291	4724676.531	70	7515479.785	4724668.773
33	7515456.744	4724682.870	71	7515472.643	4724664.028
34	7515459.468	4724686.749	72	7515462.865	4724659.035
35	7515459.923	4724687.530	73	7515455.336	4724694.121
36	7515459.992	4724687.672	74	7515456.834	4724698.703
37	7515460.058	4724687.815	75	7515458.087	4724701.885
38	7515460.259	4724688.316	76	7515459.892	4724704.790

Rilevoi / Snimio: BURIM HALILAJ
(emri dhe mbiemri i gjeodeti/kompanisë/ ime i prezime gjeodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 195

Nënshkrimi / Potpis: BHalilaj

Data e rilevimit / Datum snimanja: 21.06.2023



Aprovoi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime shërbëtorit)

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____

